



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 49
Prishtinë, më 15 shkurt 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 15 SHKURT 2012**

Mbledhjen, në fillim e kryesoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit, ndërsa pjesën e dytë, **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit.

Kryesuesi deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Në fillim, Kuvendi me propozimin e kryesuesit, mbajti një minutë heshtje në shenjë nderimi për viktimat që humbën jetën nga orteku i borës, në fshatin Restelicë të komunës së Dragashit.

Adem Grabovci, në emër të grupeve parlamentare, propozoi që Kuvendi në mbledhjen e sotme ta nxjerrë një deklaratë, për ta kundërshtuar referendumin e mbajtur nga strukturat ilegale në pjesën veriore të Kosovës.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e zotit Adem Grabovci.
Kuvendi njëzëri miratoi propozimin e cekur më lart.

Kryesuesi konstatoi se nxjerrja e Deklaratës lidhur me mbajtjen e referendumit në pjesën veriore të Kosovës, radhitet si pikë e 5-të e rendit të ditës të kësaj mbledhjeje.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
5. Deklarata kundër referendumit të strukturave paralele serbe në komunat veriore të Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arkivat,
8. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës,
9. Shqyrtimi i Propozim-Programit të punës së Kuvendit, për vitin 2012,
10. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Duda Balje, Idriz Vehapi, Hykmete Bajrami, Liburn Aliu, Biserka Kostiq, Suzan Novoberdaliu, Hamza Balje, Emilija Rexhepi, Ismet Beqiri dhe Nait Hasani, ndërsa në emër të Qeverisë, ministri Bedri Hamza dhe ministri Fehmi Mujota, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Visar Ymeri, parashtoi pyetje për kryeministrin në lidhje me atë se kur është marrë vendimi që Hashim Thaçi të takohet me presidentin e Serbisë, Boris Tadiq, e që sipas faqes së internetit WikiLeaks, ka ndodhur në vitin 2006, në Selanik dhe në vitin 2008, në selinë e OKB-së në New York.

Kryeministri Hashim Thaçi, nuk ishte prezent në sallë.

Deputeti Glauk Konjufca, parashtoi pyetje për kryeministrin në lidhje me atë se çka ka fituar Kosova nga takimet që Hashim Thaçi ka pasur me presidentin e Serbisë, Boris Tadiq, e që sipas faqes së internetit WikiLeaks, ka ndodhur në vitin 2006, në Selanik dhe në vitin 2008, në selinë e OKB-së në New York.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte prezent në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu, parashtoi pyetje për kryeministrin në lidhje me atë se kush tjetër ka marrë pjesë dhe për çfarë është biseduar në takimet që Hashim Thaçi ka pasur me

presidentin e Serbisë, Boris Tadiq, e që sipas faqes së internetit WikiLeaks, ka ndodhur në vitin 2006, në Selanik dhe në vitin 2008, në selinë e OKB-së në New York.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte prezent në sallë.

Deputeti Afrim Kasolli, parashtroi pyetje për kryeministrin në lidhje me atë se cilët persona janë në dijeni të diskutimeve në takimet që Hashim Thaçi ka pasur me presidentin e Serbisë, Boris Tadiq, e që sipas faqes së internetit WikiLeaks, ka ndodhur në vitin 2006, në Selanik dhe në vitin 2008, në selinë e OKB-së në New York.

Kryeministri Hashim Thaçi, nuk ishte prezent në sallë.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 2 shkurt 2012

Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 2 shkurt 2012, pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Ministri **Bedri Hamza** tha se qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i situatave të veçanta të cilat me ligjin 03/l-146 nuk janë mbuluar në përputhje me direktivën e BE-së për TVSH-në, që kanë të bëjnë me përcaktimin e vendit të furnizimit të mallrave për personat e tatueshëm, vendit të furnizimit, të shërbimit, transportit ndërkombëtar të pasagjerëve dhe transportit të mallrave të tyre shoqëruese, zbritjen e TVSH-së-së zbritshme dhe mallrat nën aranzhime të posaçme doganore.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri Bedri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, si dhe deputetët: Hashim Deshishku, Visar Ymeri si dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 68,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Deklarata kundër referendumit të strukturave paralele serbe në komunat veriore të Kosovës

Kryesuesi ftoi kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së që ta prezantojë dhe arsyetojë kërkesën për nxjerrjen e Deklaratës.

Adem Grabovci tha se kërkesa për Deklaratë kundër referendumit të strukturave paralele serbe në komunat veriore të Kosovës, është përkrahur dhe harmonizuar nga të gjitha grupet parlamentare, por nuk është e nënshkruar nga Grupi Parlamentar i lëvizjes "Vetëvendosje".

Deputeti Adem Grabovci më pas paraqiti tekstin e Deklaratës kundër referendumit të strukturave paralele serbe në komunat veriore të Kosovës dhe ftoi deputetët që ta miratojnë atë.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare lidhur me propozimin e zotit Adem Grabovci.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se Deklarata e paraqitur është propozuar nga të gjitha grupet parlamentare dhe e mbështesim miratimin e saj.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje" tha se do të abstenojnë në votimin e kësaj Deklarate, për arsye se në disa pika të saj potencohet Plani i Ahtisarit, dhe se duhet rishikuar teksti i Deklaratës.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se mbështesin Deklaratën kundër referendumit të strukturave paralele serbe në komunat veriore të Kosovës.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re tha se do të votojë për Deklaratën kundër referendumit të strukturave paralele serbe në komunat veriore të Kosovës.

Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se do të votojë për Deklaratën kundër referendumit të strukturave paralele serbe në komunat veriore të Kosovës.

Duda Balje, emër të Grupit Parlamentar "6+" tha se do të votojë për Deklaratën kundër referendumit të strukturave paralele serbe në komunat veriore të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë deputetët: Sabri Hamiti, Arsim Bajrami, Alma Lama, Hydajet Hyseni, Sadri Ferati, Albin Kurti dhe Ismet Beqiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi dha pauzë dreke deri në orën 15:00, për ta harmonizuar tekstin e Deklaratës.

Pas pauzës, Adem Grabovci, në emër të propozuesit tha se teksti i Deklaratës është rishikuar, në bashkëpunim me të gjitha grupet parlamentare dhe e paraqiti tekstin final të saj.

Kryetari hodhi në votim Deklaratën e propozuar nga grupet parlamentare. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	64,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash

V E N D O S I

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6, paragrafi 1 dhe nenit 49 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Duke ritheksuar se sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kosova është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm;

Duke shprehur mbështetjen për mbrojtjen dhe për realizimin e të drejtave të komuniteteve, si dhe implementimin në tërësi të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Final të Kosovës;

Duke rikonfirmuar përkushtimin dhe vullnetin për integrim institucional dhe shoqëror të komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës;

Duke u bazuar në veprimin institucional, brenda rregullave që ofron rendi juridik dhe kushtetues i Republikës së Kosovës, me propozimin e grupeve parlamentare,

Miraton këtë

D E K L A R A T Ë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës e kundërshton dhe e shpall të paligjshëm e të pavlefshëm referendumin e strukturave paralele në komunat veriore të Kosovës, të financuara e të drejuara nga Republika e Serbisë kundër Pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës;

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës e vlerëson këtë referendum cenim të rendit juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës;

3. Kuvendi i Republikës së Kosovës konstaton që i ashtuquajtimi referendum, i organizuar nga strukturat ilegale, nuk prodhon asnjë efekt juridik, politik dhe si i tillë është i pavlefshëm;

4. Kuvendi i Republikës së Kosovës vlerëson se organizimet e tilla jashtë institucionale dhe ilegale dëmtojnë përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve të Republikës së Kosovës për integrim të komunitetit serb në jetën institucionale;

5. Kuvendi i Republikës së Kosovës inkurajon komunitetin serb të pjesës veriore që sa më shpejt të angazhohet në implementimin e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës;

6. Institucionet e Republikës së Kosovës konfirmojnë gatishmërinë e tyre për mbrojtjen dhe për respektimin e të gjitha konventave ndërkombëtare, që garantojnë liritë dhe të drejtat e qytetarëve, si dhe të drejtat e pakicave.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural.

Raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e arsyetoi anëtari i këtij Komisioni, deputeti Sali Morina.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	60,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arkivat

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për arkivat.

Raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e arsyetoi kryetari i këtij Komisioni, deputeti Idriz Vehapi.

Pasi që nuk pati deputetë tjerë të paraqitur për diskutim, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	59,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për arkivat shtetërore

8. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës

Deputetja **Nazane Breca**, në emër të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, tha se si Komision kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës dhe ligjit nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës, dhe Kuvendit i kemi paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ajo u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni funksional.

Në fund, ajo kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës dhe ligjit nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Salihe Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nazane Breca, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, si dhe deputetët: Fikrim Damka, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Alma Lama, Sali Morina dhe Nazane Breca, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	66,
Kundër-----	1,
Abstenime-----	2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Miratohet raporti me rekomandime i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës dhe ligjit nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës.

9. Shqyrtimi i Propozim-Programit të punës së Kuvendit, për vitin 2012

Kryetari tha se Propozim-Programi i punës së Kuvendit, për vitin 2012, paraqet dokumentin bazë të Kuvendit për aktivitetin e organit ligjvënës të Republikës së Kosovës. Ky propozim-program është hartuar duke u bazuar në këto dokumente:

- Dokumentin e Qeverisë për strategjinë legislative për vitin 2012,
- Planet e punës së komisioneve parlamentare për vitin 2012,
- Planin e Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian për vitin 2012.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Propozim- Programit të punës së Kuvendit për vitin 2012.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit dhanë: në emër të Komisionit për Integritet Evropian, Lutfi Haziri, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Suzan Novoberdaliu, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jasmina Zhivković, si dhe deputetët: Sala Berisha – Shala, Sabri Hamiti, Albin Kurti, Hydajet Hyseni dhe Valbona Dibra, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Propozim- Programit të punës së Kuvendit për vitin 2012. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Miratohet Programi i punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2012, me plotësimin e miratimit të ligjeve që ndërlidhen me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

10. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për afat shtesë për ta shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 57.7 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar nga Kuvendi afat shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve.

Pasi nuk pati deputetë të paraqitur për diskutime, kryetari kërkoi nga Kuvendi që përmes një votimi formal, me ngritje dore, të deklarohen për kërkesën e lartpërmendur.

Kuvendi miratoi kërkesën e lartpërmendur të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, i lejohet afati shtesë, prej tridhjetë (30) ditësh, për shqyrtimin e Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 17:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale